

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **652-26-2002-1-2-1** dhe nr. brend. **KA652/26/023/121**

Sa i përket tenderit për: **Mbeshtetja e bletarëve me koshere bletësh dhe centrifuga elektrike**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

BLETARIA TE AHMETI SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR.NEXHID HASANI

(Adresa)

Vushtrri

(Vendi)

42000

(Kodi postar)

045/504 624

(Numri Telefonit)

////

(Numri i Faks-it)

Adnan Krasniqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

adnankrasniqi444@gmail.com

(Adresa elektronike)

25.05.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë”apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: **03.04.2026**

Hapja e ofertave date: **27.04.2026**

B58 Njoftimi mbi vendimin e AK-së me date: **12.05.2026**

Letra standarde për tenderuesin e pasukseshem kemi pranuar nga AK me date: **12.05.2026**

Kërkesa për rishqyrtim nga **BLETARIA TE AHMETI SHPK** permes e-prourimit me date: **18.05.2026**

Vendimi mbi refuzimin nga AK – ZPP me date: **21.05.2026**

Ankesa ne OSHP: **25.05.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Në hapjen e këtij aktiviteti të prokurimit nuk kemi marr pjesë sepse ishte elektronike përmes platformës e-prokurimi dhe konsiderojmë se ka qenë rregull procesi i hapjes.

Por, procesi verbal i hapjes është ngritur ne platformën elektronike me dt.**27.04.2026 ora: 14:27**

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

AK – ZPP ka Refuzuar KpR, mirepo nuk ka respektuar nenin 108/A të LPP-se par. 8 dhe 12 duke mos arsytuar dhe duke vazhduar me diskriminim, FAVORIZIMIN e OE të rekomanduar për kontratë në shkelje të nenit 1, 6, 7, 24, 53, 50 dhe 60 të LPP-se dhe eliminimin duke vepruar në shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së

Mirëpo AK nuk shqyrton pretendimet tona fare vetëm arsyeton se ka respektuar LPP duke mos e trajtuar fare me çështjet e ngritura në pretendimet tona ankimore dhe shqetësimet tona lidhur me këto aktivitete të prokurimit edhe përkundër që kemi argumentuar detajisht, DUKE OFRUAR PROFAVA DHE FAKTE KONKRET.

Prove: Lista e kontratave e pa notrizuar – ashtu sic është kërkuar në DT dhe NJK

AK – ZPP ka nxjerr vendim në kundërshtim me NENIN 108/A të LPP-se si dhe në kundërshtim me **nenin 7, 59 dhe 60 të LPP-se** krejt kjo është bërë me qëllim të diskriminimit tonë dhe eliminimit tonë nga konkurrenca edhe përkundër se ne jemi tenderues i përgjegjshëm me çmimin me të lirë dhe brenda vlerës

se parashikuar nga AK ne dosje tenderit dhe duke pas parasysh pretendimet tona ankimore ne pamundësi per ti kundërshtuar me fakte dhe prova konkrete pasi PRETENDMET tona ankimore kanë baze ligjore dhe qendrojn AK – ka zgjedhen formen e refuzimit te KpR pa u mbeshtet ne fakte dhe prova konkret dhe nuk eshte arsytuar ne asnje dispozit ligjore te LPP-së

Pra me fjale tjera AK ka refuzuar kërkesën tone për rishqyrtim ne kundërshtim me **nenit 108/A te LPP-se** dhe per te mos komentuar dhe ne munges te provave dhe fakteve per shkeljet qe kane ndodhur ne vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e ofertave, AK është shume i vetëdijshëm për shkeljen e dispozitave ligjore te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK – ka shkelur këto Dispozita Ligjore të LPP-së, si ne vijim:

Neni 1 Qellimi Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo Diskriminim

Neni 52 Njoftim i kriterëve per dhenien e kontrates

Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tenderve

Neni 60 Kriteret per Dhenien e Kontrates

Neni 69 AFtesia teknike dhe/Ose Profesionale

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni Shtese

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejtari fën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK – KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK me datë: **15.05.2026**, përmes platformës elektronike e-prokurim merr vendimin -**B058 Njoftimi mbi vendimin e AK** se bashku me eletrat standarde si tenderues i pasukseshem, që do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore te LPP-së, dhe Rreg. Nr. 001/20222 për PP te cilat do i argumentoj dhe dëshmojmë me prova dhe fakte konkret si ne vazhdim te kësaj KpR.

Andaj duke marr per baze dispozitat ligjore te Ligjit per Prokurimi Publike, konkretisht **ne si OE me palë me interese sipas nenit 4 par. 1.26 te LPP-se**, edhe per kunder faktit se ne kemi kemi arritur te plotesojm te gjitha kriteret e perzgjedhjes te percaktuar ne dosje tenderit dhe njoftimin per kontrate, mirepo AK – Komisioni i vleresimit – ZPP duke shkelur dispozitat ligjore te LPP, duke rekomnadar per dhenie te kontrates nje OE i cili eshte **ADMINISTRATIVISHT I PA PERGJEGJSHEM**, duke ne diskriminuar ne detyrohemi te parashtrojm fillimisht kerkese per rishqyrtim pran AK duke pasqyruar dhe nje here faktet dhe argumentet lidhur me kete AP, dhe pas refuzimit ne shkelje te nenit 108/A te LPP-se, ne detyrohemi te parashtrojme **ANKESE prane OSHP-se** edhe perkunder vullnetit tone, por jemi t ebindur se AK ne shkelje te nenit 7 duke na diskirimuar dhe duke favorizuar OE te rekomanduar per kontrate ne eliminon padrejtesisht, duke argumentuar/arsytuar me faktet dhe argumenet si ne vijim t ekesaj ANKESE:

Pretendimi: 1

Me daten: 12.05.2026 Keni pranuar nga AK B58- Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues se AK-ja ka shpallur fitues **AG-Ferm SHPK** per dhenien e kontrates lidhur me AP me Nr. te prokurimit: **652-2-6-20-0-2-1-2-1** dhe me titull: **Mbeshtetja e bletareve me koshere bletesh dhe cetrifug elektrike**

B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshë

12.05.2026 - Kaçanikj

Komuna Kaçanik , Rruga "Agim Najrami" PN.

"BLETARIA TE AHMETI" Shpk - Ceceli

Nr. i prokurimit:	652	2	6	20	0	2	1	2	1
-------------------	-----	---	---	----	---	---	---	---	---

Titulli: Mbështetja e bletarëve me koshere bletësh dhe centrifug elektrike

1/e nderuar(a) [Z/Znjj]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në v

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kriterëve të dhëna Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.

Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksessh juaj *nuk qe tenderi me çmimin më të ulët* në mesin e tenderëve që plotësonin kë njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ju informojmë se kontrata i është dhënë **"AG – FERM" Shpk - Skenderaj**


për një shumë prej 18,400.00€.

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoriteti bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republik ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin N Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kor skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërke vendimit.*

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .

Me respekt,

Izahir Kuka,
[Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit]


[Nënshkrim]

4/3

lari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assam

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Mbështetja e bletarëve me koshere bletësh dhe centrifug elektrike


Nr. i Prokurimit:	652	2	6	20	0	2	1	2	1
-------------------	-----	---	---	----	---	---	---	---	---

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ²
1.	"BLETARIA TE AHMETI" Shpk - Ceceli	19,560.00€
2.	NTP "BLETARIA EGZONI" - Gjakovë	20,570.00€
3.	"AG – FERM" Shpk - Skenderaj	18,400.00€

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Komuna e Kaçanikut shpërblen me kontratë **"AG – FERM" Shpk - Skenderaj**, fitues te kontratës në vlerë totale të ofertës 18,400.00€.

Emri dhe mbiemri i ZPP: **Izahir Kuka**



Data: 12.05.2026

Duke parë këtë vendim, konsiderojmë se AK-ja ka vepruar padrejtësisht duke shpallur Operatorin Ekonomik **“AG-FERM SHPK”** fitues, ngase tek kriteret për dhënie të kontratës, në FDT, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pika 1, është kërkuar: **“Projektet e realizuara në tri vitet e fundit për furnizime të ngjashme, llogaritur nga data e publikimit të njoftimit, në vlerë së paku 33,000.00 €**

” Ndërsa tek dëshmia është kërkuar:

“Të dorëzohet lista në origjinal e noterizuar dhe e nënshkruar e projekteve të ngjashme të realizuara që nga data e publikimit të njoftimeve të kontratës, si dhe dëshmitë për përfundimin e tyre, referencat ose pranimet e suksesshme të realizimit, të cilat duhet të korrespondojnë me listën dhe kontratat.”

Megjithatë, OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ngarkuar listën e kontratave të noterizuar, ashtu siç është kërkuar shprehimisht në dosjen e tenderit, por vetëm një letër të nënshkruar dhe vulosur, pa noterizim. Rrjedhimisht, dokumentacioni i dorëzuar nuk i plotëson kërkesat administrative dhe profesionale të përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues në dosjen e tenderit.

Duka pas parasysh se ZPP me rastin e refuzimit të KpR të datës 21.05.2026, në të cilin arsyetim nuk arsyton dhe argumonte me fakte konkrete dhe bazuar në ndonjë Dispozitë Ligjore të LPP-se, por jep këtë arsyetim, po citojmë: **“ AK sqaron se këtu është bërë gabim teknik se duke u bazuar në rregulloren me nr. 002/24 pika 26.16 se kërkesa për noterizim të AK konsiderohet të panevojshme ”**

Mirepo, **RIKUJTOJME** se për kundër këtij arsytimi nga AK – ZPP, sqarojmë edhe një herë se vlerësimi i tenderëve bëhet neperputhje me kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në NJ dhe DT – si dhe rregullat e prokurimit DOSJA e TENDERIT so dokumenti thenloret për përgaditjen e tenderëve nga OE tenderues dhe pjesëmarrës në këtë AP si dhe duke marrë për bazë fakte në platformën elektronike e-prokurimit të këtij AP asnjë OE i inetrësuar për këtë AP nuk ka kërkuar sqarime SHITES sipas nenit 53 të LPP, si dhe as KRPP nuk ka lëshuar ndonjë OPINION apo NJOFTIM për këtë kërkesë të përcaktuar AK – ZPP, atëherë OE pjesëmarrës përfshi edhe NE si OE jemi pajtuar me këtë KERKES/DESHMI të Dosjes së tenderit dhe tani në fazën e vlerësimit ky Kriter/deshmi është **“LIGJ”** dhe vlerësimi bëhet vetëm sipas kësaj kërkesë dhe duke e trajtuar si GABIM, sepse në kemi dorëzuar LISTEN KONTRATAVE të NOTERIZUAR tek Notri sepse vlerësimi i tenderëve bëhet sipas kriterëve të përzgjedhjes – **PROVE: Lista jone e dorëzuar e NOTERIZUAR nga noteri** dhe cdo devijim nga kjo kërkesë në këtë fazë të vlerësimit është diskriminuese për ne si OE pjesëmarrës dhe Favorizuese për OE dhe marrë për bazë të gjithë këto fakte dhe argumente të deshmuar dhe faktuar në prokurim, KONSTATOHET se OE i rekomanduar për kontratë është administrativisht i pa përgjegjshëm, sepse nuk ka dorëzuar listen e kontratave të noterizuar nga noteri dhe për këtë dokumentet nuk mund të përdoret as Neni 59.2 dhe 72 të LPP-se, prandaj OE në fjalë i rekomanduar nga AK – ZPP është i pa përgjegjshëm dhe duhet të elemnohet dhe nuk mund të shpallet i përgjegjshëm në asnjë rrethanë sepse shkelet **neni 7, 53, 59, 60 dhe 72 të LPP-së.**

PRANDAJ NE SI OE ANKUESE:

KERKOJM NGA eksperti shqyrtues – autorizuar nga OSHP TE SHTJELLOJ DHE ARGUMENTOJ ME FAKTE DHE ARGUMENTET TE DESHMUAR NE DISPOZITA LIGJORE TE LPP PA QEN I/E NDIKUAR DHE NE PERPUTHJE ME FAKTET NE E-PROKURIM DHE DESHMIT E DOREZUAR NGA OE I REKOMANDUAR KONFORM NENIT 113 DHE 114 TE LPP-së!.....

Me këtë veprim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me:

- Nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), i cili obligon AK-në të sigurojë trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe transparencë ndaj të gjithë operatorëve ekonomikë;
- Nenin 59 të LPP-së lidhur me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, pasi AK-ja ka qenë e obliguar të refuzojë ofertën që nuk përmbush kërkesat administrative të dosjes së tenderit;
- Nenin 69 të LPP-së lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale, ku OE duhet t'i përmbushë saktësisht kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara nga AK-ja;
- Si dhe nenin 40 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se tenderët që nuk janë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit duhet të konsiderohen tenderë të papërgjegjshëm.

Prandaj, konsiderojmë se OE i rekomanduar nuk ka plotësuar kushtet e kërkuara në FDT dhe si i tillë është dashur të eliminohet nga procedura e vlerësimit

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit kemi konstatuar se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar vërtetim të ATK-së i cili nuk është lëshuar për qëllime të prokurimit publik, por për qëllime krediti, rrjedhimisht dokumenti i tillë nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe nuk mund të konsiderohet dokument valid për vërtetimin e obligimeve tatimore në procedurë të prokurimit.

Po ashtu, konstatojmë se ka kaluar afati prej 90 ditësh i validitetit të ofertës / sigurimit të ofertës, pa pasur vazhdim valid të tij sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe dispozitave ligjore në fuqi. Pranimi i një oferte me validitet të skaduar përbën shkelje të parimeve themelore të prokurimit publik, përfshirë trajtimin e barabartë, transparencën dhe ligjshmërinë e procedurës

Me këto veprime konsiderojmë se janë shkelur dispozitat e:

- Nenin 7 të Ligjit për Prokurim Publik lidhur me trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin;
- Dispozitat që rregullojnë vlefshmërinë e ofertës dhe dokumentacionit administrativ sipas dosjes së tenderit dhe rregullave të KRPP-së.

Andaj, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

1. Të rishqyrtojë vendimin për dhënie të kontratës;
2. Të eliminojë nga procedura OE-në e rekomanduar i cili nuk i plotëson kushtet administrative dhe të validitetit;
3. Të bëjë rivlerësimin e ofertave në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik.

Në të kundërtën, do të detyrohemi të vazhdojmë procedurat ligjore pranë organeve kompetente.

I. BAZA LIGJORE

1. Ligji për Prokurimin Publik në fuqi, nenet:
 - o Neni 68 – Kriteret për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë;
 - o Neni 69 – Dokumentet dhe mënyra e vërtetimit të kapaciteteve;
 - o Neni 70 – Parimet e vlerësimit dhe barazisë së trajtimit;
 - o Neni 112 – E drejta për vërejtje dhe ankimim.
2. Dokumentacioni i Prokurimit, pjesa: **Kriteret e Përzgjedhjes, pika: Kapaciteti profesional/teknik – Projekte të ngjashme të realizuara.**
- 3.

II. PËRCAKTIMI I KRITERIT NGA DOKUMENTACIONI

Sipas njoftimit të kontratës, operatori ekonomik kërkohet të dëshmojë:

"Projektet e realizuara në tri vitet e fundit për furnizime të ngjashme, të llogaritura nga data e publikimit të njoftimit, me vlerë kumulative minimale 33.000,00 €."

Data e publikimit: 03.04.2026 Periudha e vlefshme e referencave: 03.04.2023 – 03.04.2026 Vlera minimale e kërkuar: 33.000,00 € (tridhjetë e tri mijë euro)

III. ANALIZA E REFERENCAVE TË DORËZUARA NGA OE "AG-FERM SH.P.K."

1. Laboratori për aktivitete të biznesit – Data: 02.10.2023 – Periudha e vlefshme: Po – Vlera: Nuk specifikohet – MUNGON Deshmia – Referenca Raporti i pranimit apo/ose pagesa bankare
2. Komuna e Mitrovicës – Drejtoria për Bujqësi – Data: 02.10.2023 – Periudha e vlefshme: Po – Vlera: Nuk specifikohet - MUNGON Deshmia – Referenca Raporti i pranimit apo/ose pagesa bankare
3. Help – German Cooperation – Data: 02.10.2023 (referenca aktuale daton 2020) – Periudha e vlefshme: Jo – Vlera: Nuk specifikohet - MUNGON Deshmia – Referenca Raporti i pranimit apo/ose pagesa bankare
4. IADK – Zenel Bunjaku – Data: 23.09.2020 – Periudha e vlefshme: Jo – Vlera: 4.778,54 € (jashtë afatit) - MUNGON Deshmia – Referenca Raporti i pranimit apo/ose pagesa bankare
5. Fondacioni Amaneti – Blerim Arifi – Data: 04.06.2025 – Periudha e vlefshme: Po – Vlera: Nuk specifikohet - MUNGON Deshmia – Referenca Raporti i pranimit apo/ose pagesa bankare
6. Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Bujqësisë – Data: 09.02.2024 – Periudha e vlefshme: Po – Vlera: Nuk specifikohet - MUNGON Deshmia – Referenca Raporti i pranimit apo/ose pagesa bankare
7. Komuna e Vitisë – Zyra e Prokurimit – Data: 13.02.2024 – Periudha e vlefshme: Po – Vlera: 13.800,00 € - MUNGON Deshmia – Referenca Raporti i pranimit apo/ose pagesa bankare
8. SHHBK "Nënë Tereza" – Data: 23.09.2020 – Periudha e vlefshme: Jo E lëshuar për subjekt tjetër (ISUF Ramaj B.I.) – Vlera: N/A MUNGON Deshmia – Referenca Raporti i pranimit apo/ose pagesa bankare

IV. KONSTATIME FAKTIKE DHE LIGJORE

1. Vlera e verifikueshme brenda periudhës së kërkuar (03.04.2023–03.04.2026) është vetëm 13.800,00 € (referenca e Komunës së Vitisë).
2. Referencat e tjera brenda kësaj periudhe nuk përmbajnë vlerë financiare të specifikuar, prandaj, sipas parimit të sigurisë juridike dhe praktikës së prokurimit publik, nuk mund të llogariten në shumën kumulative të kërkuar.
3. Referencat e vitit 2020 (IADK, Help, SHHBK) janë jashtë afatit ligjor 3 vjeçar të përcaktuar nga dokumentacioni i prokurimit. Sipas nenit 69 të Ligjit për Prokurim Publik, dokumentet duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në njoftim; referencat e skaduara nuk pranohen për vërtetim të kapacitetit aktual.
4. Referenca e SHHBK "Nënë Tereza" është lëshuar për një operator tjetër ekonomik (ISUF Ramaj B.I.) dhe nuk ka asnjë vlerë provuese për OE "AG Ferm SH.P.K.", sipas parimit të personalitetit juridik dhe përgjegjësisë së veçantë të subjekteve.
5. Shuma totale e verifikuar dhe e pranueshme: 13.800,00 € Shuma minimale e kërkuar: 33.000,00 € Mungesa: 19.200,00 € (58.18% nën kufirin minimal).

Gjithashtu, marr per baze se **AK- ZPP** me rastin e refuzimit te kerkese per Rishqyrtim nga ZPP i cili nuk ka dhena asnje sqarime lidhur me pretendimet ankimore nga jone ashtu sic ka qen i Obliguar sipas **nenit 108/A par. 8 dhe 12 te LPP-se**, **KEKROJM FILLIMISHT NGA EKSPERTI SHQYRTUES AUTORIZUAR NGA OSHP**, te analizoj, hulumtoj dhe konstatoj kete pretendim tone me fakte dhe argument se OE i rekomanduar per Kontrate nuk ka arrit te plotesoj kete kriter te perzgjedhjes te percaktuar ne DT dhe NJK, per faktin sepse nje kontrate e nenshkruar nga palet nuk do te thote detyrimisht se do te ekzekutohet apo/ose eshte ekzekutuar perderi sa nuk ka nje referenc ne po ate vlere apo/ose edhe nje raport pranimi nga menaxheri i kontrate – Komisioni i pranimit i nenshkruar nga palet. Praktike e Prokurimit Publik ka deshmuar se kontrata nenshkuar por nuk ekzekutohet apo/ose deshton OE ta ekzekutoj apo edhe nderpritet nga AK – **KERKOJM APROVIMIN E PRETENDIMIT TONE SI TE BAZUAR PER FAKTIN SE SHUME KONTRATA TE PREZANTUAR JANE JASHTE PERRIU DHES 3 VJEQARE NGA data e publikimit te njofimit per kontrate ashtu sic e kerkon neni 69 LPP-se, SI DHE SHUEM KONTRATA TE DOREZUAR NUK POSEDOJN – referenca, Raporte Pranimi te mallit apo/ose edhe deshmin e pagese nga Banka,?!.....Eksperti Shqyrtues ta analizoj dhe ARGUMENTOJPRETENDIMIN TONE ANKIMORER per faktin se AK – ZPP ka deshtuar te argumentoj per fakti se jemi diskriminuar ne shkleje te nenit 7 te LPP-se, sepse AK me rastin e qasjes ne dokumente nuk ka dhene asnje prove per sqarime shtes eper OE te rekomanduar per kontrate dhe eshte konstatuar se Komisioni i vleresimiti dhe ZPP kane shkelur dispozitat ligjore te LPP-se lidhur me vleresimin dhe favorizimin e OE me rastin e rekomandimit per kontrate pasi qe nuk ka arri te plotesoj vleren e realizimit te kontratve me referenca, raporte pranim apo pagesa nga banka ne vlerenL 33,000.00 € si kerkese e DT dhe NJK – Kriter i perzgjedhjes ne FDT.**

IV. KËRKESË ZYRTARE

Bazuar në analizën e mësipërme dhe në përputhje me nenin 7, 53, 59 dhe 60 të Ligjit për Prokurim Publik, i cili parasheh që vlerësimi të bëhet në mënyrë objektive, të barabartë dhe sipas kritereve të paracaktuara në dokumentacion,

Kërkoj që ZPP Komisioni i RI- Vlerësimit:

- 1. Të konstatojë zyrtarisht se OE "AG-Ferm SH.P.K." nuk e plotëson kriterin minimal të kapacitetit profesional për furnizime të ngjashme në vlerë prej 33.000,00 € në periudhën 03.04.2023–03.04.2026;**
- 2. Të përjashtojë ofertën e këtij operatori nga faza e vlerësimit teknik/financiar, sipas nenit 68, pika 3, e Ligjit për Prokurim Publik;**
- 3. Të regjistrojë këtë vërejtje në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit dhe në dosjen e prokurimit, si dokument i domosdoshëm për transparencë dhe mbrojtje nga ankesat e mundshme;**
- 4. Të njoftojë me shkrim operatorin ekonomik për arsyet e vendimit, në përputhje me të drejtën e informimit dhe ankimit (neni 112).**

Duke u bazuar ne dëshmitë dhe faktet qe u cekun me lartë rezulton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë ne harmoni me **nenin 59 dhe 60 te LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie te kontratës, e qe ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin me te ulet, sipas **nenit 60 paragrafi1.1 i LPP-së**.

Paragrafi 1 i nenit 7 te LPP-së e parasheh qarte qe *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”*, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate.

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsideratë edhe **nenin 1 te LPP-së**, pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejt te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si dhe te gjitha fondeve dhe burimeve te tjera te autoriteteve kontraktues ne Kosoves.

Duke u bazuar ne te gjitha faktet dhe dëshmitë qe u ceken me larte, fillimisht kerkojme nga ESH rekomandim profesional dhe te bazuar ne fakte dhe argumente sipas **nenit 114 te LPP-së** te sqaroj sakt dhe drejt ne menyre meritore pa qene i/e ndikuar, pastaj po ashtu edhe nga PSH qe te merr:

V E N D I M

APROVOHET, - si te bazuar ANKESA nga OE: **BLETARIA TE AHMETI SHPK**

ANULOHET, - njoftimi mbi vendimin e AK-se për dhenie te kontrates dhe lënda te kthehet ne **RIVLERESIM**, - Autoriteti kontraktues qe gjate rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimi i ofertave te bëhet ne harmoni me kërkesat e dosjes se tenderit, njoftimit për kontratë dhe konforme dispozitave te LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi te detyruar te vazhdojmë procedurën ligjore ne institucionet tjera kompetente, dhe do te kerkojmë llogari përmes rrugëve ligjore nga te gjithapalët qe kane marr pjesë nekëtë aktivitet te prokurimit

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

e veprimet e ndërmarra nga Autoriteti Kontraktues, operatorit tonë ekonomik i është shkaktuar dëm material dhe cenim i interesit juridik, pasi pavarësisht përmbushjes së kërkesave të dosjes së tenderit dhe dorëzimit të dokumentacionit konform kërkesave të FDT-së, kontrata është rekomanduar për një operator ekonomik i cili nuk i ka plotësuar kriteret administrative dhe profesionale të kërkuara.

Si rezultat i këtij vendimi të kundërligjshëm, OE ynë rrezikon të humbasë mundësinë për realizimin e kontratës publike, duke pësuar humbje financiare direkte në fitimin e paraparë nga realizimi i kontratës, shpenzimet e përgatitjes së tenderit, angazhimet operative dhe dëmtimin e pozitës konkurruese në procedurën e prokurimit.

Gjithashtu, ekziston rreziku që dëmi material të rritet edhe më tej në rast të vazhdimit të procedurës dhe nënshkrimit të kontratës me OE të papërgjegjshëm, duke e bërë të pamundur rikthimin e gjendjes në ligjshmëri pa pasoja financiare për operatorin tonë ekonomik.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, originalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.**